

---

**RREGULLORE NR. 2002/3**

**MBI TATIMIN NË FITIM NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e ndryshuar t] UNMIK-ut nr. 1999/16 të datës 6 nëntor 1999 mbi Autoritetin Qendror Fiskal dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore,

Duke marrë parasysh autoritetin përfundimtar të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me paragrafin 8.1 (c) të Rregullores nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 të UNMIK-ut mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë për përcaktimin e parametrave financiarë dhe politikën e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe faktin se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes nuk janë themeluar në tërësi, të cilat nuk janë në gjendje të japin këshilla përmes Këshillit Ekonomik dhe Fiskal për çështjet e përfshira në këtë Rregullore,

Me qëllim të themelimit të tatimit në fitim,

Shpall sa vijon:

**KAPITULLI I – DISPOZITATAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1  
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

“Organizatë biznesi” do të thotë:

(a) Ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, kompani me kapital të përbashkët ose kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 të datës 8 shkurt 2001 mbi Organizatat e afariste dhe

(b) Organizatë afariste që ushtron veprimtarinë e saj me mjete në pronësi publike ose shoqërore.

“Dividendë” do të thotë pjesa të cilën kompania ia ndan një aksionari nga:

(a) Paratë e gatshme ose stoqet në bazë të pjesës së interesit të aksionarit në kompani dhe

(b) Prona tjetër nga paratë e gatshme ose stoqet, përveç asaj që është rezultat i likuidimit.

“Veprimtari ekonomike” do të thotë veprimtaria e ushtruar me qëllim të fitimit të të ardhurave.

“Pasqyrat financiare” do të thotë pasqyrat financiare të karakterit të përgjithshëm të përgatitura në përputhje me Rregulloren nr. 2001/30 të datës 29 tetor 2001 mbi Themelimin e Bordit të Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar dhe të një Regjimi për raportimin financiar të organizatave afariste.

“Të ardhurat e burimeve të jashtme” do të thotë të ardhurat bruto që nuk janë të ardhura të brendshme.

“Të ardhurat bruto” do të thotë të gjitha të ardhurat e fituara ose të akumuluar që përfshijnë veçmas të ardhurat nga veprimtaritë e prodhimit, tregtisë, financave, investimeve, veprimtarisë profesionale ose veprimtarive të tjera ekonomike brenda periudës tatimore, pavarësisht nga koha e marrjes së tyre.

“Pronë e paprekshme” nënkupton patentet, të drejtën e autorit, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pronën tjetër që përbëhet vetëm nga të drejtat, por që nuk ka formë fizike.

“Të ardhura nga burimet e Kosovës” do të thotë të ardhura bruto që krijohen në Kosovë, e që veçmas përfshijnë:

(a) Interesin në detyrimet e borxheve që i bën një kompani vendëse ose organ qeveritar i Kosovës,

(b) Dividendën nga një kompani vendëse,

(c) Të ardhurat nga puna dhe shërbimet e ushtruara në Kosovë,

(d) Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme në Kosovë,

(e) Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së paprekshme në Kosovë,

(f) Fitimin nga shitja e pasurisë së patundshme që ndodhet në Kosovë,

(g) Fitimin nga shitja e pasurisë së tundshme (përveç inventarit) nëse shitësi është banor i Kosovës,

(ë) Primet për sigurimin ose risigurimin e rrezikut në Kosovë.

“Jorezident” do të thotë një person ose grup personash që nuk janë banorë të Kosovës.

“Ndërmarrje e përhershme” do të thotë çdo vend pune përmes të cilit personi jorezident bën biznes në Kosovë. Kjo përfshin veçmas: uzinat, filialat, përfaqësitë, fabrikat, punëtoritë dhe vendndërtimet.

“Person” do të thotë person juridik ose fizik.

“Person i ndërlidhur” do të thotë person me lidhje të veçanta me personin që tatimohet. Personat konsiderohen se kanë lidhje nëse:

- (a) Janë zyrtarë ose drejtorë të bizneseve të njëri-tjetrit,
- (b) Janë partnerë të ligjshëm në biznes,
- (c) Kanë lidhje punëdhënësi-punonjësi,
- (d) Një person që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi posedon, kontrollon ose mban pesëdhjetë për qind (50 %) a më shumë të aksioneve ose të të drejtave të votimit në kompani, me ç’rast personi dhe kompania konsiderohet se janë të lidhur,
- (e) Njëri prej tyre drejtpërsëdrejti ose tërthorazi e kontrollon tjetrin,
- (f) Që të dytë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kontrollohen nga personi i tretë i njëjtë dhe
- (e) Ata janë anëtarë të së njëjtës familje duke përfshirë bashkëshort(in)en paraardhësin ose pasardhësin, vëllain ose motrën, nipin ose mbesën, bashkëshortinë e motrës ose të vëllait, motrën ose vëllain e njërit prind ose vjehrrit, kunetërit ose kunatat.

“Shpenzimet e reprezentacionit” do të thotë të gjitha shpenzimet lidhur me promovimin e biznesit ose produkteve të tij të cilat përfshijnë veçmas shpenzimet e publicitetit, reklamimit, zbavitjes dhe reprezentacionit.

“Rezident” do të thotë një person ose grup i personave që është i vendosur në Kosovë ose që e ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në Kosovë.

“Administratë tatimore” do të thotë administrata në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal me autorizimet e përcaktuara në Rregulloren nr. 2000/20 dhe instrumentet tjera ndihmëse,

“Periudha tatimore” do të thotë viti kalendarik.

## Neni 2 Tatimpaguesit

2.1 Sipas kësaj Rregulloreje tatimpagues janë personat e mëposhtëm:

- (a) Organizata afariste e cila sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 duhet t’i përgatisë pasqyrat financiare,

(b) Organizata afariste e cila zgjedh t'i përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/30,

(c) Një ndërmarrje e përhershme e një personit jorezident dhe

(d) Një organizatë e regjistruar në UNMIK si organizatë joqeveritare në bazë të Rregullore së UNMIK-ut nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 mbi Regjistrimin dhe Punën e Organizatave Joqeveritare në Kosovë.

2.2 Tatimpaguesit sipas kësaj Rregulloreje nuk janë përgjegjës për tatimin e paragjykuar në bazë të Rregullore së UNMIK-ut nr. 2000/29 të datës 20 maj 2000 mbi Themelimin e Tatimit të Paragjykuar.

### Neni 3 Tatimi në fitim

3.1 Prej datës 1 prill 2002 një tatim fitimi do të vëhet në fitimin e tatueshëm të tatimpaguesve në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

3.2 Tatimi në fitim do të vëhet në fitimin e tatueshëm të tatimpaguesve në përqindjen prej njëzet për qind (20 %).

### Neni 4 Fitimi i tatueshëm

4.1 Fitimi i tatueshëm përcaktohet duke i përshtatur të ardhurat dhe shpenzimet e tatimpaguesit të shënuara në pasqyrën financiare në mënyrën e përkufizuar me këtë Rregullore, përveç atyre tatimpaguesve të përmendur në nenin 2.1 (d) dhe nenin 27 të kësaj Rregulloreje.

4.2 Fitimi i tatueshëm për tatimpaguesin rezident është fitimi i tatueshëm nga burimet e të ardhurave në Kosovë dhe të ardhurave të jashtme.

4.3 Fitimi i tatueshëm për tatimpaguesin jorezident është vetëm fitimi i tatueshëm nga të ardhurat brenda Kosovës.

## **KAPITULLI II – TË ARDHURAT QË LIROHEN NGA TATIMI**

### Neni 5 Fitimet e liruara

Të ardhurat e mëposhtme lirohen nga tatimit në fitim:

(a) Të ardhurat e organizatave të regjistruara në UNMIK si organizata joqeveritare me status bëmires publik me kusht që fitimi i të ardhurave të shfrytëzohet vetëm për qëllime bëmirëse,

(b) Të ardhurat e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe

(c) Dividendat e marra nga një tatimpagues rezident i një kompanie rezidente që ka paguar tatimin në fitim në Kosovë.

(d) Të ardhurat nga një kontraktues, përveç një kontraktuesi vendës, që janë krijuar nga kontratat për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara (duke përfshirë UNMIK-un), agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore.

### **KAPITULLI III – SHPENZIMET**

#### Neni 6

#### Shpenzimet e lejueshme

6.1 Në varësi të kufizimeve të kësaj Rregulloreje, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, tatimpaguesit i lejohej si zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periodës tatimore dhe vetëm në lidhje me veprimtarinë e saj ekonomike.

6.2 Nuk lejohej fare zbritje për kurrfarë shpenzimesh përveç nëse dokumentohet sipas mënyrës së paraparë me udhëzimin administrativ që do ta nxjerrë Autoriteti Qendror Fiskal.

#### Neni 7

#### Shpenzimet e palejueshme

Gjatë përcaktimi të fitimit të tatueshëm shpenzimet e mëposhtme janë të palejueshme:

- (a) Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës,
- (b) Shpenzimet e përvetësimit, përmirësimit, ripërtëritjes dhe rindërtimit të mjeteve të cilat janë zhvlerësuar ose amortizuar në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje,
- (c) Gjobat dhe denimet,
- (d) Tatimi në të ardhura, tatimi në fitim dhe tatimi i paragjykuar dhe
- (d) Tatimi në vlerën e shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kredi për tatimin në repromaterial në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/11 të datës 31 maj 2001 për Tatimin në Vlerën e Shtuar.

#### Neni 8

#### Kontributet bëmirëse

Kontributet e dhëna për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas kësaj Rregulloreje lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej 5 për qind (5 %) të fitimit të tatueshëm të llogaritur para zbritjes së shpenzimeve.

#### Neni 9

## Shpenzimet e reprezentacionit

Sipas kësaj Rregulloreje shpenzimet për reprezentacion lejohen deri në maksimumin prej 2 për qind (2 %) të qarkullimit të përgjithshme.

### Neni 10 Borxhet e këqija

10.1 Borxhe të këqija sipas kësaj Rregulloreje konsiderohen shpenzimet që i përmbushin tri (3) kushtet e mëposhtme:

- (a) Nëse shuma që i përgjigjet borxhit është përfshirë më parë në të ardhura,
- (b) Nëse borxhet janë shlyer në librat e tatimpaguesit si të pavlefshme dhe
- (c) Nëse ekziston dëshmi adekuate e përpjekjeve esenciale të pasuksesshme të bëra nga tatimpaguesi për arkëtimin e borxhit.

10.2 Borxhet e këqija që janë zbritur si shpenzime dhe pastaj janë arkëtuar më vonë përfshihen si të ardhura në momentin e arkëtimit.

### Neni 11 Fondet rezervë

11.1 Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë Rregullore, kontributet në fondet rezervë nuk lejohen si shpenzime.

11.2 Bankat kanë të drejtë në shpenzime për krijimin e fondit të posaçëm rezervë për mjetet e dyshimta të bankës në shumën e cila nuk duhet të kalojë shumën maksimale të lejueshme nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës.

11.3 Pas krijimit të fondit të posaçëm rezervë, çdo shumë e tërhequr prej fondit duhet të përfshihet në të ardhura dhe në çdo shumë të kthyer në fond për ta rimbushur atë deri në shumën e lejueshme do të lejohet si zbritje.

### Neni 12 Pagesat për personat e ndërlidhur

12.1 Kompenzimi ose pagat e paguara për personin e ndërlidhur lejohen si shpenzime në shumën e cila është e barabartë me çmimin e tregut.

12.2 Kamata, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personit të ndërlidhur lejohen si shpenzime të barabarta me çmimin e tregut.

### Neni 13 Zhvlerësimi

13.1 Shpenzimet për pronën e prekshme (përveç shpenzimeve për tokën, veprat artistike dhe pronën tjetër e cila nuk konsumohet) që i posedon tatimpaguesi dhe që shfrytëzohen për veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit do të kompenzohen me kalimin e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.

13.2 Tërë prona e prekshme e tatimpaguesit, e cila i nënshtrohet zhvlerësimit sipas paragrafit 13.1, vendoset në njërën prej kategorive të mëposhtme:

(a) Kategoria 1: Ndërtesat dhe konstruksionet tjera ndërtimore,

(b) Kategoria 2: Automobilat dhe kamoinat e lehtë, kompjuterët, pjesët periferike dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, orenditë e zyrave dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjetra shitesë dhe

(c) Kategoria 3: Uzinat dhe makineria, mjetet e rënda transportuese, pajisjet për largimin e dheut, automjetet tjera të rënda, vagonët dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanët, anijet dhe të gjitha mjetet tjera të prekshme.

13.3 Prona në secilën kategori duhet të trajtohet si më poshtë:

(a) Kategoria 1: prona duhet të evidencohet në llogari të veçanta të mjeteve,

(b) Kategoria 2: prona duhet të vendoset në një grumbull dhe të ketë një llogari kapitale të konsoliduar dhe

(c) Kategoria 3: pronat duhet të vendoset në një grumbull dhe të ketë një llogari kapitale të konsoliduar.

13.4 Shuma e lejuar si zbritje e zhvlerëuar për periodën tatimore përcaktohet duke zbatuar përqindjet e mëposhtme për llogaritë kapitale për kategori të tilla në përfundimin e periodës tatimore:

(a) Kategoria 1 - pesë për qind (5 %).

(b) Kategoria 2 - njëzet për qind (20 %) dhe

(c) Kategoria 3 - pesëmbëdhjetë për qind (15 %).

13.5 Një aktiv së pari duhet të merret parasysh për qëllimin e këtij neni herën kur për herë të parë vihet në shërbim.

13.6 Shtimi fillestar në llogarinë kapitale për ndonjë aktiv të përvetësuar gjatë vitit duhet të jetë çmimi i tij plus sigurimi dhe bartja. Plotësimi fillestar i llogarisë kapitale për ndonjë pronë të ndërtuar nga tatimpaguesi përfshin tatimet, detyrimet dhe kumatën që i ngarkohet kësaj prone për periudhat para se të vihet në shërbim prona.

13.7 Shuma fillestare në llogarinë kapitale për mjetet e poseduara para 1 janarit 2002 duhet të jetë vlera e librave të mjeteve në datën 1 janar 2002.

13.8 Shpenzimi për ndonjë aktiv më i vogël se 1000 euro, që i takon kategorisë 2 ose 3, lejohet si shpenzim rrjedhës.

Neni 14  
Zbritje e posaçme për pasuritë e reja

Nëse një tatimpagues blen ndonjë aktiv që i takon kategorisë 3 për qëllimet e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit ndërmjet 1 janarit 2002 dhe 31 dhjetorit 2006, lejohet një zbritje e veçantë prej pesë për qind (5 %) të çmimit të përvetësimit të aktivit në vitin në të cilin aktiviteti është vënë për herë të parë në shërbim. Kjo zbritje do bëhet përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm. Zbritja lejohet vetëm nëse aktiviteti është i ri ose është vënë për herë të parë në shërbim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse aktiviteti është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë.

Neni 15  
Riparimet dhe përmirësimet

Në rastin e llogarive të mjeteve të veçuara dhe të ndonjë llogarie mjeteve të grumbulluara:

(a) Shumat e tilla do lejohen si zbritje për atë vit nëse ato mjete të shpenzuara gjatë periodës tatimore për të riparuar, mirëmbajtur ose përmirësuar pronën nuk e kalojnë shumën prej 5 për qind (5 %) të bilancit të llogarisë në fillim të atij viti dhe

(b) Tejkallimet e tilla do të trajtohen si përmirësime dhe i shtohen llogarisë së mjeteve të veçuara ose llogarisë së gumbulluar, nëse shumat e tilla janë më mëdha se 5 për qind (5 %).

Neni 16  
Amortizimi

16.1 Shpenzimet për mjetet e paprekshme të cilat kanë kohëzgjatje të kufizuar të përdorimit (përfshirë patentet, të drejtat autoriale, licencat për pikturat dhe modelet, kontratat dhe franshizat) zbriten në formën e detyrimeve të amortizimit.

16.2 Metoda e amortizimit është metodë e vijës së drejtë dhe zbritja bazohet në kohëzgjatjen e përdorimit të aktivitetit, siç është përcaktuar me marrëveshjen ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e aktivitetit të paprekshëm.

Neni 17  
Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore

17.1 Të gjitha shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore në lidhje me rezervat natyrore të mineraleve dhe resurseve të tjera natyrore (dhe kamata me të cilat ngarkohen ato) i shtohen llogarisë kapitale dhe amortizohen në bazë të këtij neni.

17.2 Shuma e lejuar si zbritje e amortizimit në lidhje me shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore të përmendura në paragrafin 17.1 për periodën tatimore do të përcaktohet duke shtuar bilancin në llogarinë kapitale me një shumë:

a) Numëruesi i të cilit paraqet njësitë e nxjerra prej depozitave natyrore gjatë vitit dhe

b) Emëruesi i të cilit paraqet shumën e njësisive të përgjithshme të parapara për t'u nxjerrë nga depoziti natyral gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit.

17.3 Njësitë e përgjithshme të parapara për nxjerrje, të referuara në nenin 17.2 (b) do të përcaktohen në mënyrën e cila do të përshkruhet në një udhëzim të ardhshëm administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

## **KAPITULLI IV – FITIMET DHE HUMBJET E KAPITALIT, HUMBJET E BIZNESIT**

### Neni 18

#### Fitimi dhe humbja e kapitalit

18.1 Me përfitimin e kapitalit nënkuptohen të ardhurat që një tatimpagues i realizon përmes shitjes ose ndonjë mënyre tjetër të tjetërsimit të pasurisë, duke përfshirë pasurinë e patundshme dhe letrat me vlerë.

18.2 Lartësia e përfitimit të kapitalit është dallimi pozitiv ndërmjet çmimit të shitjes së aktivitetit dhe çmimit të aktivitetit siç është përcaktuar në paragrafin 18.7.

18.3 Humbja e kapitalit është humbja që e realizon tatimpaguesi nëpërmjet shitjes apo tjetërsimit në ndonjë mënyrë tjetër, duke përfshirë pasurinë e patundshme dhe letrat me vlerë.

18.4 Lartësia e humbjes së kapitalit është dallimi negativ ndërmjet çmimit të shitjes së aktivitetit dhe çmimit të aktivitetit, siç është përcaktuar në paragrafin 18.7.

18.5 Çmimi i shitjes së aktivitetit është shuma e të gjitha parave të marra plus vlera e vërtetë e çdo prone në treg (përveç parave) që merren si kundërvlerë për shitje.

18.6 Nëse çmimi i shitjes është më i ulët se çmimi në treg, atëherë sipas këtij neni çmimi i shitjes është çmimi në treg.

18.7 Kostoja e aktivitetit është shuma që tatimpaguesi ka paguar për të përvetësuar aktivitetin që rritet me shpenzimet e përmirësimeve dhe që zvogëlohet me zhvlerësimin dhe shpenzimet e tjera që mund t'i ngarkohen pasqyrës financiare ose atyre që lejohen sipas kësaj Rregulloreje.

18.8 Ky nen nuk vlen për pasurinë që i nënshtrohet zhvlerësimit si mjete të grumbulluara.

18.9 Përfitimet e kapitalit njihen si të ardhura afariste, ndërsa humbjet e kapitalit njihen si humbje afariste.

### Neni 19

#### Konvertimet e paqëllimshme

Përfitimi i kapitalit nuk pranohet në rast të ndërrimit padashje të pronës në atë masë që kompensimi i marrë nga ndërrimi përbëhet nga prona e karakterit a natyres së njëjtë ose nga paratë që janë investuar në pronën e natyres a të karakterit të njëjtë brenda periodës dyvjeçare (2) të zëvendësimit.

Neni 20  
Humbjet afariste

- 20.1 Humbjet afariste janë dallimi negativ ndërmjet të ardhurave të tatimpaguesit dhe shpenzimeve të dala nëpërmjet aktiviteteve ekonomike.
- 20.2 Shuma e humbjeve afariste e përkufizuar sipas këtij neni do të bartet përpara deri në pesë (5) perioda të njëpasnjëshme tatimore dhe mund të zbritet nga të ardhurat që fitohen gjatë këtyre viteve.
- 20.3 Shuma e bartur që merret parasysh për çfarëdo periodë tatimore pas vitit të humbjes afariste do të jetë shuma e përgjithshme e humbjes e zvogëluar për shumën e grumbulluar që është lejuar më parë si zbritje.
- 20.4 Nëse tatimpaguesi ka pasur humbje afariste më gjatë se një (1) vit, ky nen zbatohet për humbjet që janë krijuar sipas radhës.

**KAPITULLI V – ORGANIZIMET, RIORGANIZIMET DHE LIKUIDIMET**

Neni 21  
Shpërndarja e pronës

- 21.1 Kompania që ia shpërndan pronën (përveç aksioneve) një aksionari duke pasur parasysh interesin e aksionarit pranon fitimin ose humbjen sikur ajo pronë t'i ishte shitur aksionarit në vlerën e vërtetë të tregut.
- 21.2 Vlera e pronës për aksionarin është vlera e vërtetë e pronës në treg.
- 21.3 Në rast të shpërndarjes së dividendëve të aksioneve që nuk ndërrojnë hisen e pjesëmarrjes së përfituesit, kompania nuk e njeh fitimin as humbjen dhe kështu aksionari nuk realizon të ardhura.

Neni 22  
Likuidimet

- 22.1 Në rast të likuidimit të një kompanie, kompania merr parasysh humbjen apo fitimin sikur ta kishte shitur pronën që është shpërndarë gjatë likuidimit në vlerën e vërtetë të saj në treg.
- 22.2 Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë Rregullore, përfituesit e pronës së shpërndarë gjatë likuidimit trajtohen sikur ta kishin këmbyer interesin e vlerës së mbetur në kompaninë e likuiduar për shumën që është e barabartë me vlerën e vërtetë të asaj prone në treg.
- 22.3 Në rast të likuidimit të një filiali ku prona e filialit i shpërndahet një filiali ëmë, filiali ëmë nuk pranon kurrfarë humbjesh ose fitimesh.

Neni 23  
Riorganizimi

23.1 Transferimet e pronës në pajtim me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit (për shkak të bankrotimit, bashkimit, përvetësimit apo ndonjë arsyeje tjetër), që e miraton Administrata tatimore, nuk i nënshtrohen tatimeve sipas kësaj Rregulloreje.

23.2 Në rast të riorganizimit, vlera e pronës së tatimpaguesit që riorganizohet në librin e llogarive përcaktohet në bazë të vlerës së asaj prone në librin e llogarive menjëherë para riorganizimit.

23.3 Gjatë riorganizimit, shpërndarja e interesit të vlerës së mbetur që u bëhet aksionarëve nuk paraqet fitim të të ardhurave për aksionarët.

23.4 Përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe me ndonjë udhëzim administrativ që e nxjerr Autoriteti Qendror Fiskal, tatimpaguesi përfitues trashëgon dhe merr parasysht inventarin, shumën e humbjes së bartur, konton e dividendës dhe të gjitha zërat tjera, kështu që tatimpaguesi që përfiton ia zëvendëson tatimpaguesin përfitues përkitazi me ato zëra.

## **KAPITULLI VI – ÇMIMET E TRANSFERIMIT, SHMANGIA E TATIMEVE TË DYFISHTA**

### Neni 24

#### Çmimet e transferimit

24.1 Çmimi që shfrytëzohet në lidhje me transaksionet e mjeteve apo obligimeve kontraktuese ndërmjet personave përkatës konsiderohet çmim transferi.

24.2 Çmimi që pritet të merret në lidhje me transaksionet e mjeteve apo detyrimeve kontraktuese ndërmjet palëve që janë marrë vesh “duarlibër” apo më shumë se “duarlibër” konsiderohet të jetë çmimi “duarlibër”.

24.3 Çmimi “nga largësia” përcaktohet sipas metodës komparative të çmimeve të pakontrolluara dhe, në rastet kur kjo nuk mund të shfrytëzohet, do të përdoret metoda e çmimeve të rishitjes ose metoda e kostos-plus.

24.4 Diferenca ndërmjet çmimit “nga distanca” dhe çmimit të transferimit përfshihet në përfitimin që i nënshtrohet tatimit.

### Neni 25

#### Shmangia e tatimeve të dyfishta

25.1 Tatimpaguesi me banim në Kosovë që përfiton prej aktiviteteve afariste jashtë Kosovës me anë të ndonjë biznesit të përhershëm jashtë Kosovës dhe që paguan tatim në atë fitim në cilindo shtet sipas kësaj Rregulloreje i lejohet një kredi tatimore në shumën që është e barabartë me tatimin e paguar në një shtet të tillë.

25.2 Çdo kredi tatimore sipas kësaj Rregulloreje kufizohet me shumën e tatimit që duhet të paguhet sipas kësaj Rregulloreje për fitimin e realizuar në një shtet të këtillë.

25.3 Çdo marrëveshje e zbatueshme bilaterale për shmangien e tatimit të dyfishtë e bërë mes Kosovës dhe çfarëdo shteti tjetër i shfuqizon dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## **KAPITULLI VII – MOSPAGIMI I TATIMEVE**

### Neni 26

#### Mospagimi i tatimeve mbi fitime, interes dhe pagesa

26.1 Çdo tatimpagues që ua paguan dividendën, interesin ose qiranë për shfrytëzimin e pasurisë nëntokësore personave që nuk janë banorë të Kosovës i mban 15% për qind të tatimit në kohën e pagesës dhe e zbret tatimin e mbajtur (papaguar) në Administratën tatimore.

26.2 Nëse shumat tatimore nuk janë ndalur, ose janë ndalur por nuk janë transmetuar, tatimpaguesi ia paguan Administratës tatimore tatimin që nuk është ndalur ose nuk është transmetuar si dhe kamatën lidhur me të dhe dënimin përkatës për periodën e mospagimit.

## **KAPITULLI VIII – DISPOZITA TË VEÇANTA**

### Neni 27

#### Trajtimi i kompanive të sigurimit

Në rastin e ndonjë subjekti, aktiviteti kryesor i të cilit është sigurimi ose risigurimi i jetës, pronës dhe rreziqeve të tjera, tatimi që caktohet me këtë Rregullore është shuma e cila është e barabartë me shtatë (7) për qind të primeve bruto të grumbulluara gjatë periodës tatimore.

## **KAPITULLI IX – DISPOZITAT ADMINISTRATIVE**

### Neni 28

#### Deklarimi i tatimeve

28.1 Tatimpaguesit i dorëzojnë administratës tatimore pasqyrat tatimore në formuralin e caktuar me një udhëzim administrativ që e nxjerr Autoriteti Qendror Fiskal më 1 prill ose para periodës tatimore të vitit vijues.

28.2 Tatimpaguesit i dorëzojnë administratës tatimore pasqyrat financiare që kërkohen sipas Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2001/30, së bashku me pasqyrat e tyre tatimore.

### Neni 29

#### Pagesat e tatimit dhe kamatat për pagesat e vonuara

29.1 Çdo tatimpagues paguan tatimet me këste tremujore më 15 prill, më 15 korrik, më 15 tetor dhe më 15 janar ose para këtyre datave që lidhet me tremujorin kalendarik që i paraprin këtyre datave. Shuma që duhet paguar në çdo këst tremujor është një e kartëta (1/4) e detyrimit të përgjithshëm për atë periodë tatimore qoftë në bazë të vlerës së llogaritur të fitimit të tatueshëm për atë periodë tatimore apo të fitimit të llogaritur që i nënshtrohet tatimit për vitin paraprak, përveç periodës tatimore 2002 dhe periodës së parë tatimore të tatimpaguesit, detyrimi sipas këtij paragrafi do të bazohet në vlerën e llogaritur të fitimi të tatueshëm.

29.2 Çdo tatimpagues kryen rregullimin përfundimtar të tatimeve dhe paguan shumën përfundimtare të duhur më një prill apo para një prillit të vitit pas periodës tatimore. Shuma që duhet paguar për shlyerjen e borxhit tatimor është dallimi ndërmjet tatimit të përcaktuar për periodën tatimore në pajtim me këtë Rregullore dhe shumës së përgjithshme të paguar në këste tremujore.

29.3 Nëse shuma e përgjithshme e paguar në këste tremujore është më e madhe se tatimi paraprakisht i llogaritur prej administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë të kthimit të shumës së tepërt të tatimeve të paguara.

29.4 Nëse tatimpaguesi nuk paguan shumën e duhur për këstet tremujore apo për shumën e duhur përfundimtare ose vonohet për pagesa të këtilla, kamata e dallimit ndërmjet shumës së duhur dhe shumës së paguar përcaktohet në pajtim me interesin e huadhënies komerciale në Kosovë siç deklarohet publikisht administrata tatimore kohë pas kohe. Përveç kësaj, tatimpaguesit mund t'i vlerësohen dënimet sipas nenit 31 të kësaj Rregulloreje.

29.5 Nëse pagesat e kësteve tremujore bëhen në datën apo para datës së duhur dhe nëse pagesa përfundimtare për rregullimin e tatimit bëhet siç parashihet me nenin 29.2 të kësaj Rregulloreje, atëherë nuk kërkohet kurrfarë kamate apo dënimi për pagesë të pamjaftueshme nëse:

- (a) Dallimi ndërmjet shumës së duhur për çdo këst dhe shumës së paguar në çdo këst nuk tejklon 10% e shumës së duhur dhe
- (b) Pas periodës tatimore 2002 dhe pas periodës së parë tatimore, shuma e paguar në çdo këst është shjetë për qind më shumë se një e katërta e vlerës së tatimit të llogaritur prej administratës tatimore për periodën paraprake tatimore.

#### Neni 30

#### Inspektimi i shënimeve, llogaritjeve dhe mbledhja e detyruar e mjeteve

- 30.1 Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe instrumentet e filialeve:
- (a) Administrata tatimore mund të kërkojë dorëzimin e dokumentacionit dhe informatave tjera që kanë të bëjnë me të ardhurat, shpenzimet, pasurinë e zhvelftësueshme dhe informata të tjera të nevojshme për llogaritjen e përfitimit që mund t'i nënshtrohet tatimeve;
  - (b) Administrata Tatimore mund të lëshojë një njoftim në lidhje me vlerësimin dhe mund të kërkojë pagesën nga ata persona që nuk arrijnë ta dorëzojnë deklaratën ose ta paguajnë këstin e llogaritur në mënyrë të arsyeshme apo pagesën përfundimtare për rregullimin e tatimeve dhe
  - (c) Administrata tatimore mund të shfrytëzojë metoda të detyrimit për vjeljen e tatimeve nëse tatimpaguesi nuk paguan shumën e duhur brenda kohës së paraparë.

#### Neni 31

#### Shkeljet dhe dënimet

Çdo person që shkel këtë Rregullore u nënshtrohet dënimeve të parashikuara në ligjin në fuqi, duke përfshirë edhe ato të parapara në Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe në instrumentet e filialave.

#### Neni 32

#### Ankesat

Çdo person që është nën ndikimin e drejtpërdrejtë të vendimit zyrtar sipas kësaj Rregulloreje ka të drejtë ankimi ndaj këtyre vendime në pajtim me Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe instrumentet e filialave.

## **KAPITULLI X – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### Neni 33 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në pajtim me të.

### Neni 34 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

### Neni 35 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 shkurt të vitit 2002.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm